



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2022:017276  
Datë: 11.06.2024  
Numri i dokumentit: 05810537

KPPP.nr. 1050/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të debitorit të kundër përmbarimit Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike SH.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, kundër kreditorëve të kundër përmbarimit 1. D.P. “Qengji i Sharrit”, 2. D.P.H. “Victoria”, 3. D.P.H. “Kafiterija Casablanca” dhe 4. N.T.P. “Rena Impex”, të gjithë me seli në Ferizaj, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Jakup Ramadani, avokat nga Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të debitorit për kundër përmbarim të paraqitur me datë 27.01.2022, nga debitori i kundër përmbarimit Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike SH.A. (KEDS), jashtë seance, më datën 11.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente për të vendosur sipas propozimit për kundër përmbarim të paraqitur nga debitori i kundër përmbarimit Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike SH.A. (KEDS), në lëndën me numër KPPP.nr. 1050/23, ndaj kreditorëve të kundër përmbarimit 1. D.P. “Qengji i Sharrit”, 2. D.P.H. “Victoria”, 3. D.P.H. “Kafiterija Casablanca” dhe 4. N.T.P. “Rena Impex”.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm.

## A r s y e t i m

Debitori Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike SH.A. (KEDS), me datë 27.01.2022, pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, ka paraqitur propozim për kundër përmbarrim ndaj kreditorëve të kundër përmbarrimit 1. D.P. “Qengji i Sharrit”, 2. D.P.H. “Victoria”, 3. D.P.H. “Kafiterija Casablanka” dhe 4. N.T.P. “Rena Impex”.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin E.nr.96/22, të datës 04.05.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për kundër përmbarrim të debitorit Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike SH.A. (KEDS). Kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë debitori i kundër përmbarrimit KEDS SH.A.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.346/23, të datës 06.06.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit të kundër përmbarrimit KEDS SH.A. dhe lënda është kthyer në rivendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, duke u kujdesur për kompetencën e saj lëndore, pas shqyrtimit paraprak të propozimit për kundër përmbarrim, gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij propozimi është kompetente Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarrimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Mjetet juridike në procedurë përmbarrimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarrimore janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarrimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit Ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarrimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është*

*i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.”*

Duke u bazuar në dispozitat e sipërcituara rezulton se Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Komerciale të Kosovës, është kompetente për shqyrtimin e mjeteve të rregullta në procedurë përmbarimore dhe atë për prapësim dhe ankesë për çështje brenda kompetencës së kësaj gjykate.

Në rastin konkret, meqenëse objekti i shqyrtimi të çështjes ka të bëjë me caktimin dhe zbatimin e përmbarimit sipas propozimit për kundër përmbarim të debitorit të kundër përmbarimit Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike SH.A. (KEDS), ndaj kreditorëve të kundër përmbarimit 1. D.P. “Qengji i Sharrit”, 2. D.P.H. “Victoria”, 3. D.P.H. “Kafiterija Casablanka” dhe 4. N.T.P. “Rena Impex” me seli në Ferizaj, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, vlerëson se nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është caktimi dhe zbatimi i përmbarimit nga gjykata si organ përmbarues sipas propozimit për kundër përmbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Në bazë të neneve 17 dhe 19, të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, parashihet që gjykata gjatë tërë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore, e të cilat dispozita gjykata i zbatoi përshtatshëmish në këtë procedurë konform nenit 17 të LPP-së.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1050/23, datë 11.06.2024

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.